

Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumn-it në bashkëpunim me Njësinë Bazë të Infermierisë dhe Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, me nismën e studentëve të infermierisë organizuan një aktivitet sensibilizues në kuadër të "Ditës Botërore të Luftës Kundër HIV/AIDS".

Ky aktivitet pati si qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e HIV/AIDS, duke ofruar informacion edukues dhe këshillim për të rinjtë. Aktiviteti synoi të theksojë rëndësinë e kujdesit shëndetësor, të promovojë mënyrat e mbrojtjes nga infeksioni dhe të eliminojë stigmën dhe paragjykimet ndaj personave që jetojnë me HIV/AIDS.

Në kuadër të këtij aktiviteti u organizuan biseda informuese, shpërndarje materialesh edukative dhe mundësi për konsultime me profesionistë të shëndetit publik.

Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin përfaqësues të NJVKSH-së, pedagogë, studentë të fakulteteve të ndryshme.

